# DËSHMI ARKIVI

**A-449770**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kthyen lokalin në “pikë” droge, arrestohen 3 persona në Elbasan |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/16/kthyen-lokalin-ne-pike-droge-arrestohen-3-persona-ne-elbasan/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 15:46:54 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 15:44:21 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a0d6b7445a4e3d4650c846bde188bac82aae720e557afc3ec5a41765dab0eaba` |
| TEKSTI | `485b7d299f21b66459c35cdd4822f368b4845c77d56d379f794e0092bf550cb9` |
| PAMJA | `4e5aa0aab9cf9a2fb198bc57b0b83ffd38a8ae2d6157accd9a103493985b3a6c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `af3abf0816913f063b9eb7af72906c345b42ef0666b99cff2421c670f0625d17` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/af3abf0816913f063b9eb7af72906c345b42ef0666b99cff2421c670f0625d17`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Kthyen lokalin në "pikë" droge, arrestohen 3 persona në Elbasan

Kronike

Publikuar: 16/09/2026




Tre persona janë arrestuar në Elbasan, pasi akuzohen se në bashkëpunim me njëri-tjetrin përgatisnin dhe shisnin doza të drogave të ndryshme.

Sipas Policisë, aktiviteti i dyshuar zhvillohej në një lokal në fshatin Mjekës, ku dyshohet se përgatiteshin, ndaheshin në doza dhe shiteshin kokainë dhe kanabis.

Në kuadër të operacionit të koduar "Roli", në pranga ranë të rinjtë me inciale D. R., 26 vjeç, i cili kishte marrë me qira lokalin, dhe L. Q., 18 vjeç, që punonte aty si kamerier.

Hetimet vijuan me kontrollin e banesës së 18-vjeçarit, ku policia thotë se gjeti sasi dhe doza të dyshuara kanabisi, si dhe një shkop metalik. Në përfundim të veprimeve u arrestua edhe vëllai i tij me inicialet E. Q., 24 vjeç.

Gjatë operacionit u sekuestruan dhjetëra doza lëndësh të dyshuara narkotike, gjashtë grirëse, tre peshore elektronike, dy celularë dhe një shkop metalik.

*"Si rezultat i veprimeve intensive hetimore dhe operacionale, të kryera nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me Seksionin për Mbështetjen Operacionale të Hetimit, dhe të drejtuara nga Prokuroria e Elbasanit, me qëllim dokumentimin e veprimtarisë kriminale të 3 shtetasve, të cilët në bashkëpunim, shitnin lëndë narkotike, në doza, u finalizua operacioni i koduar 'Roli'.*

*Gjatë operacionit u konstatua se një lokal në fshatin Mjekës, ishte vënë në dispozicion të përgatitjes, ndarjes në doza dhe shitjes së lëndëve narkotike Kokainë dhe Cannabis Sativa.*

*Në vijim të veprimeve procedurale u arrestuan shtetasi që kishte*

Më të lexuarat


"Punë oligarkësh", apo jo z.zëvendësministër?


Lanë në burg Veliajn, Valbon Çekrezi i lidhur me krimin e organizuar, Genti Shala fshehu pasurinë...


E vetmja gjë që nuk ka ndryshuar është përndjekja politike ndaj Erion Veliajt...


"Babai i deputetes më ka përdhunuar", Zegjine Çaushi reagon pas denoncimit të 24-vjeçares, publiko...


Xhuvi Sarxhi mori leje për 8 kate, po ndërton pallat 12 kate. Prestanome e kunatit të Bashës (Eri...

*marrë me qira lokalin dhe kamerieri, D. R., 26 vjeç dhe L. Q., 18 vjeç, të dy banues në fshatin Mjekës. Nga kontrollet në ambientet e lokalit u gjetën doza të këtyre lëndëve, si dhe mjete që shërbenin për përgatitjen e dozave.*

*Më tej, u krye kontroll në banesën e 18-vjeçarit, ku u gjetën sasi dhe doza të lëndës së dyshuar narkotike Cannabis Sativa, si dhe një shkop metalik, që dyshohet se posedoheshin nga vëllai i 18-vjeçarit, shtetasi E. Q., 24 vjeç, i cili në përfundim të veprimeve procedurale u arrestua për veprat penale 'Prodhimi dhe shitja e narkotikëve' dhe 'Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta'.*

*Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme"*, njoftoi policia.




## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.





Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.